

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**« SARI S ENERGY GROUP » Sh.p.k**

Në Durrës, sot më datë 16.07.2024 (dymijë e njëzetë e katër) :

- 1. SAIMIR CENOLLARI**, i lindur më 05.11.1975, në Shijak dhe banues në, Shijak, shtetas shqiptar, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr 035644443 dhe nr personal H51105150J, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Vendosën sa vijon:

**NENI 1**

Themelohet shoqëria tregtare : « **SARI S ENERGY GROUP** » shpk.

Ortakët themelues të saj janë:

**1. SAIMIR CENOLLARI**

Shoqeria tregtare « **SARI S ENERGY GROUP** » do të jetë shoqëri me përgjegjesi të kufizuar. Emërtimi i shoqërisë do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.

**NENI 2**

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: “ Zona Kadastrale 3255 Nr.pasurise 178/32,Sallmone , Shijak ”.

**NENI 3**

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit. Me vendim të ortakëve, mund të krijohen ose anullohen (në rast se janë çelur), seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitetë e tjera strukturore të shoqërisë si degë apo përfaqësi edhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

**NENI 4**  
**Kapitali i shoqërisë**

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 10.000 lekë,formuar nga ortakët themelues, i ndarë në 1 (nje) kuote, zotëruar nga ortaku themelues :

**z.SAIMIR CENOLLARI** me vlerë të përgjithshme 10.000 lekë dhe përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Shoqëria mund të ndryshojë kapitalin themeltar; Transferimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes në favor të ortakëve të tjera;

Po kështu transferimi i Kuotave bëhet sipas neneve 72; 73 ;74 ;75 dhe përgjithësisht siç parashihet në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve.



Ortakët kanë të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

#### NENI 5

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është pa afat.

#### NENI 6

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

#### NENI 7

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashegimie, në përputhje me ligjin dhe statutin.

#### NENI 8

Shoqëria « **SARI S ENERGY GROUP** » Sh.p.k, krijuhet për të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit që do të jetë:

**“Import , eksport ,prodhim dhe tregtimi i energjisë së rinovueshme .”**

#### NENI 9

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtimet të tjera të cilat janë me interes për mbarëvajtjen e shoqërisë.

#### NENI 10

Me vendim të Asamblesë së ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjera, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

#### NENI 11

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është Organi me i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " i njeh asamblesë së ortakëve që janë krijuar me ortakëri.

Ortakët mund t'ia delegojnë kompetencat një ose më shumë administratorëve të caktuar prej tyre ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë.

#### NENI 12

Administrator i shoqërisë « **SARI S ENERGY GROUP** » Sh.p.k, emërohet:

**SAIMIR CENOLLARI** , i lindur më 05.11.1975, në Shijak dhe banues në, Shijak, shtetas shqiptar, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr 035644443 dhe nr personal H51105150J, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

Administratori i shoqërisë, **Saimir Cenollari** , emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar nga data e nënshkrimit të këtij akti.



### NENI 13

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 kopje originale, me të njëjtën vlerë ligjore, një kopje depozitohet në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ky akti u lexua dhe u kuptua nga nënshkruesi i cili deklaron se akti është i rregullt tërësisht dhe në çdo paragraf në përputhje me vullnetin e lirë e të plotë të tij,

Nënshkruesi jep pëlqimin për sa përmendet në akt dhe e nënshkruan rregullisht në çdo faqe dhe emër, mbiemër dhe firmë në mbyllje të aktit.

**ORTAKU  
SAIMIR CENOLLARI**

Saimir Cenollari

